



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

THIRRJE PËR EKSPERTË TË JASHTËM

Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) në mbështetje të nenit 50, pika 3 të ligjit nr.97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, në zbatim të Strategjisë së Autoritetit të Mediave Audiovizive për vitet 2021- 2023, ku kërkohet “Rishikimi periodik, që synon përmirësimin e vazhdueshëm të tij (Kodit të Transmetimit) dhe si detyrim ligjor, bazuar në praktikat e deritanishme, problemet e evidentuara dhe propozimet e mundshme nga grupet e interesit”, kërkon një ekspertë të jashtëm të kualifikuar për të vlerësuar nevojën e rishikimit të Kodit ekzistues të Transmetimit.

TERMAT E REFERENCËS

1. Qëllimi

Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA) me qëllim përmirësimin e cilësisë dhe efektivitetit të rolit të mbikëqyrjes dhe rregullimit, në përputhje me respektimin e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut, me standardet e parimet etike e morale të shoqërisë, me respektimin në mënyrë të veçantë të të drejtave të të miturve për të qenë të mbrojtur, për t’u shprehur dhe për t’u informuar, në respektimin e privatësisë, dinjitetit, pluralizmit, paanësisë etj, kërkon të rishikojë Kodin e Transmetimit.

2. Detyrat

- Eksperti i jashtëm do të punojë për të realizuar detyrat e mëposhtme:
- 2.1 Të vlerësojë Kodin aktual të Transmetimit dhe të propozojë ndryshime në përputhje me zhvillimet teknologjike dhe shoqërore;
- 2.2 Në përputhje me praktikat më të mira evropiane në këtë fushë të ndihmojë në draftimin ligjor të propozimeve në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe transparente;
- 2.3 Të asistojë AMA-n gjatë konsultimit publik me grupet e interesit.

3. Eksperti i kualifikuar duhet të plotësojë këto kritere:

- 3.1 Të ketë arsimim juridik,
- 3.2 Të ketë njohuri shumë të mira të legjislacionit kombëtar e ndërkombëtar në fushën e mediave, të drejtave të njeriut, mbrojtjes të të miturve, respektimin e privatësisë etj.;
- 3.3 Të jetë njohës i rekomandimeve të institucioneve ndërkombëtare në këto fusha;
- 3.4 Eksperiencë mbi 15 vite;
- 3.5 Të ketë kontribut në institucione vendimmarrëse, akademike, etj.;
- 3.6 Të jetë i angazhuar në instanca kombëtare e ndërkombëtare për të drejtat e njeriut;
- 3.7 Të ketë realizuar punë të ngjashme.

4. Dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga aplikuesit për ekspert të jashtëm:

- 4.1 CV ku përfshihen të dhëna të detajuara për arsimimin dhe eksperiencën në punë.
- 4.2 Kopje e diplomës së universitetit
- 4.3 Kopje të librezës së punës (që vërtetojnë eksperiencën në punë)
- 4.4 Dokumente që vërtetojnë realizimin e punëve të ngjashme.
- 4.5 Kopje të ID
- 4.6 Të gjitha dokumentat e kërkuara në pikat 4.2 – 4.5 të jenë kopje të njehësuar me origjinalin.

5. Kriteret e vlerësimit për përzgjedhjen e ekspertit të jashtëm:

- 5.1 Eksperienca mbi 15 vite në njohje të legjislacionit kombëtar në fushën e mediave, të drejtave të njeriut, mbrojtjes të të miturve, respektimin e privatësisë etj **70 pikë**
- 5.2 Punë të ngjashme **30 pikë**

Aplikuesit duhet të dorëzojnë të gjithë dokumentacionin e kërkuar brenda datës 14 Janar 2022, ora 12:00, pranë zyrës së Arkiv – Protokollit, të AMA-s.

Adresa: Rruga “Papa Gjon Pali II”, nr.15, Tiranë.

AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

Tiranë, më 14.12.2021